



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS
DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI JURIDIK**

PROJEKTVENDIM

NR _____, DATË ____ / ____ / 202__

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT MBI MONITORIMIN E ZBATIMIT TË BUXHETIT
TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2024**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr.68/2017 datë 27/04/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit të Minsitrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.22 dt. 30/07/2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore”, kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe,

TË VENDOSË :

1. Miratimin e Raportit mbi monitorimin e zbatimit të buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2024, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohen të gjitha Drejtoritë, Njësitë Administrative, Ndërmarrjet dhe Insitucionet e Bashkisë Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

DREJTORIA E BUXHETIT
Drejtör

Valbona Qiriako

DREJTORIA LIGJORE
Drejtör

Alneida Rroshi

KRYETAR I BASHKISË

Emiriana Sako



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës

RELACION

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT MBI MONITORIMIN E ZBATIMIT TË
BUXHETIT TË BASHKISË Durrës PËR VITIN 2024**

Të nderuar këshilltarë,

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit nr. 68/2017 datë 27/04/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22 datë 30/07/2018 "Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", Drejtoria e Buxhetit harton 3 raporte periodike për çdo 4 muaj për monitorimin e zbatimit të buxhetit. Këto raporte i dërgohen për informim edhe Ministrisë së Financave.

Drejtoria e Buxhetit bazuar në akt rakordimet vjetore me Degën e Thesarit Durrës të të ardhurave të realizuara dhe shpenzimeve të kryera nga të njëmbëdhjetë njësitë shpenzuese në bashkëpunim me Drejtoritë e tjera të Bashkisë që buxhetojnë ka përpiluar raportin vjetor të zbatimit të buxhetit për çdo program buxhetor, ku jepet informacion i plotë për përdorimin e fondeve buxhetore sipas programeve buxhetore, si dhe realizimit të të ardhurave të Bashkisë në vitin 2024.

Në bazë të pikës 15 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22 datë 30/07/2018 "Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", ky raport i paraqitet Këshillit Bashkiak për miratim.

Për sa më sipër i kërkojmë Këshillit Bashkiak Durrës:

1. Të miratojë "Raport mbi monitorimin e zbatimit të buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2024", pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

GRUPI PËR MENAXHIMIN STRATEGJIK NË BASHKINË Durrës

Emiriana Sako	Kryetar	Kryetar i Bashkisë
Gentian Kallmi	anëtar	Zëvendëskryetar

Elio Jani	“	Zëvendëskryetar
Renis Mullaj	“	Zëvendëskryetar
Almiva Llaçi	“	Drejtor Dr. Kabinetit të Kryetarit të Bashkisë
Alneida Rroshi	“	Drejtor Dr. Ligjore
Roni Shqiopa	“	Drejtor Dr. së Taksave dhe Tarifave Vendore
Ermal Lufo	“	Drejtor Dr. Ekonomike
Ardian Iljazaj	“	Drejtor Dr. Shërbimeve dhe Punëve Publike
Lorenc Faça	“	Drejtor Dr. Projekteve dhe Infrastrukturës Publike
Valbona Qiriako	“	Drejtor Dr. Buxhetit
Dhurata Gjoka	“	Drejtor Dr. Burimeve Njerëzore
Robert Dervishi	“	Drejtor Dr. Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit
Lorenc Smajli	“	Drejtor Dr. Turizmit
Adrian Gurra	“	Drejtor Dr. Arsimit, Kulturës, Sportit, Rinisë dhe Kom.Fetare
Meme Xhaferaj	“	Drejtor Dr. Shërbimit Social
Xhulio Llazo	“	Drejtor Dr. Informatikës dhe Dixhitalizimit